




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



American TV of Kosova
Xhelal Tetaj
Drejtor
Pejë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2023/94 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për American TV of Kosova (Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. Pala përgjegjëse me datë 31 janar 2019 është pajisur me licencë të KPM-së me seli në Pejë. Me marrjen e Licencës Pala përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datë 17 dhjetor 2021 ka nxjerrë Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marrë parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejtë dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës.
3. KPM me datë 27 qershor 2021, i ka dërguar e-mail Palës përgjegjëse për mes të cilit i ka përkujtuar lidhur me obligimin e fillimit të transmetimit sipas Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.
4. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse pas dërgimit të e-mail-it.
5. KPM me datë 24 dhjetor 2021, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, ka realizuar edhe monitorimin dhe ka gjetur se Pala përgjegjëse, ka qenë jashtë transmetimit.
6. KPM me datë 11 janar 2022, duke u bazuar në Raportin e monitorimit, përmes një shkresë ka kërkuar nga Pala përgjegjëse që menjëherë pas pranimit të shkresës të fillojë transmetimin e programit si dhe të ofrojë me shkrim arsyet e ndërprerjes së transmetimit.
7. KPM, nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse pas dërgimit të shkresës.

8. KPM me datë 11 gusht 2022, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele, ka realizuar edhe monitorimin e dytë dhe ka gjetur se Pala përgjegjëse, nuk ka respektuar afatin prej 90 ditësh për të filluar me transmetim ashtu siç është përcaktuar me nenin 24 të Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele.
9. KPM, me datë 19 tetor 2022, përmes telefonit ka tentuar të komunikojë me Palën përgjegjëse. Mirëpo nuk ka arritur të kontaktojë në numrat të cilët i ka deklaruar për komunikim me KPM-në.
10. KPM, me datë 6 prill 2023, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele, ka realizuar edhe monitorimin e tretë dhe ka gjetur se Pala përgjegjëse, nuk ka respektuar afatin prej 90 ditësh për të filluar me transmetim ashtu siç është përcaktuar me nenin 24 të Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele.
11. Pala përgjegjëse gjithashtu ka dështuar të kryej edhe pagesën e tarifës së Licencës për vitin 2021 dhe 2022.

Analiza ligjore

12. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse është gjetur në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele, Rregulloren KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë.
13. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 dispozitat kalimtare të Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele-KPM-2021/01, i cili përcakton se:

“Të gjithë të Licencuarit për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, të cilët nuk janë duke transmetuar, obligohen që në një afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje të fillojnë transmetim të programit në pajtueshmëri me kushtet dhe termet e licencës. Në të kundërtën KPM, pas këtij afati, do të marrë vendim për ndërprerjen e licencës së tyre.”
14. KPM bazuar në Raportin e dytë të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse edhe përkundër shkresës se datës 11 janar 2022 ka dështuar të respektoj afatin prej 90 ditësh për të filluar me transmetim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 24 të Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele.
15. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 4.6 “Ndërprerjet e transmetimit” të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele për Transmetim përmes Operatorëve të Shpërndarjes, i cili përcakton se:

“Ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të transmetimit në veprimtarinë e ofrimit të shërbimit të programeve përmes operatorit të shpërndarjes, do të bëjnë që nga ana e KPM-së të rishikohen rrethanat dhe mund të çojnë në anulimin e Licencës ”.

16. KPM bazuar në Raportet e monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4.6 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale për Transmetim Përmes Operatorëve të Shpërndarjes, duke e ndërprerë transmetimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimit të programeve përmes operatorit të shpërndarjes, pa e njoftuar KPM-në për një veprim të tillë. Bazuar në nenin 4.6 të Kushteve të Licencës ndërprerjet e shpeshta të zgjatura dhe të paarsyeshme të transmetimit mund të rezultojnë edhe në anulimin e licencës së transmetimit.
17. Pala përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/06 i cili përcakton se:
“Tarifa vjetore për licencë, për të gjitha kategoritë e të Licencuarve së KPM-së, do të depozitohet në tërësi në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur të Mediave deri më 30 qershor të vitit respektiv”.
18. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/06. Pa ashtu bazuar edhe në raportin e financave Pala përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/06, duke dështuar ta bëjë pagesën e tarifës për vitin 2021 dhe 2022.
19. Komisioni duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 24 të Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale-KPM-2021/01, nenit 4.6, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, nenit 13 paragrafi 1 të Rregullores KPM-2017/06.
20. Komisioni si rrethanë rënduese për Palën përgjegjëse, ka konsideruar dështimin e pagesës së tarifës së licencës, obligime këto të përcaktuara me Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore të KPM-së.


Vendim

21. Pala përgjegjëse të sanksionohet me ndërprerje të licencës së transmetimit në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.6 të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenin 4.6 , të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, nenit 24 të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale-KPM-2021/01, nenit 13 paragrafi 1 të Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë.
22. Pala përgjegjëse, obligohet që edhe pas ndërprerjes të licencës së transmetimit të kryej obligimin ligjor ndaj KPM-së, në lidhje me pagesën e tarifës për licencë për vitin 2021 dhe 2022 ashtu siç

është e përcaktuar me nenin 13, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë.

E drejta për ankesë

23. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
24. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI
Kryetar



20.03.2024

Datë